



## FTESË

### Diskutim publik rreth zonimit të sipërfaqes rurale të Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë dhe Programi për Zhvillim Gjithpërfshirës/UN-Habitat-i ftojnë banorët e Vushtrrisë, përfaqësuesit e fshatrave, shoqërisë civile, komunitetet e ndryshme dhe të gjitha grupet e interesit në përgjithësi që të marrin pjesë në diskutimin publik rreth zonimit të sipërfaqes rurale të Vushtrrisë.

Në këtë takim do të diskutojmë të gjithë së bashku për draft-zonat ekzistuese dhe të propozuara brenda kufirit rural, kushtet përmes të cilave këto zona do të rregullohen si dhe draft-infrastrukturën publike/sociale, të transportit (rrugore) dhe teknike.

Organizimi është pjesë e procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës, një dokument me karakter zonifikues dhe rregullues i cili përfshin tërë territorin e Komunës, dhe pas aprovimit do të shërbejë si bazë për zhvillim fizik të territorit komunal. Procesin e planifikimit në tërësi e përkrahë edhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) me të dhëna dhe këshilla/ konsultime.

Datat dhe lokacionet e takimeve për zonën rurale janë të renditura në tabelën më poshtë:

DATA	VENDI	KOHA	FSHATRAT
E premte, 4 Qershor	<b>Pantinë</b> (Shkolla fillore "Gjergj Kastrioti Skënderbeu")	11:00	Pantinë, Akrashticë, Shtitaricë, Hercegovë, Balincë, Oshlan, Liqej, Bukosh, Taraxhë, Dalak
E premte, 4 Qershor	<b>Smrekonicë</b> (Shkolla fillore "Enver Hadri")	14:00	Smrekonicë, Banjskë, Doberllukë, Pasomë, Sllatinë, Tërllobuq, Shlivovicë
E shtunë, 5 Qershor	<b>Stroc</b> (Shkolla fillore "Liria")	11:00	Stroc, Mihaliq, Gllavotin, Bivolak, Zhilivodë, Beçuk
E shtunë, 5 Qershor	<b>Novolan</b> (Shkolla fillore "Emin Duraku")	14:00	Novolan, Reznik, Vërnice, Kollë, Bruznik, Dubovc, Beçiq, Galicë, Druar, Shalë
E premte, 11 Qershor	<b>Studime e Poshtme</b> (Shkolla fillore "Ali Kelmendi")	11:00	Studime e Poshtme, Begaj, Gojbulë, Studime e Epërme, Gumnishtë, Vesekoc, Miraçë, Skromë, Kurillovë, Boshlan, Karaçë
E premte, 11 Qershor	<b>Stanoc i Epërm</b> (Shkolla fillore "Migjeni")	14:00	Stanoc i Epërm, Stanoc i Poshtëm, Gracë, Prelluzhë, Lumadh
E shtunë, 12 Qershor	<b>Samadrexhë</b> (Shkolla fillore "Lumni Surdulli")	11:00	Samadrexhë, Dumnicat (3), Maxhunaj, Vilancë, Ropicë, Ceceli, Pestovë, Nadakoc, Sllakoc, Svaracak, Zagorë, Skoçan, Kunovik

Ju mirëpresim!

Me respekt,  
Drejtorja e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit  
Komuna e Vushtrrisë

**Takimet do të mbahen sipas masave anti-COVID në fuqi.**

Ky aktivitet mbështetet nga:



INCLUSIVE  
DEVELOPMENT  
PROGRAMME

Program i zbatuar nga:



Financohet nga:

SWEDISH DEVELOPMENT  
COOPERATION

